

Statut I nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar

Ne kete statut:

-“Ligji” eshte Ligji Nr. 9901,dt.14.04.2008 “Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”;

-“Statuti” eshte Statuti I shoqerise;

Kreu 1

Themelimi,Emri,Objekti,Kohezgjatja,Selia

Neni 1

Data e Themelimit,Emri dhe Themeluesit

- (1) Sot me dt 13.07.2017,une, themeluesi,ortak I vetem kam krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin DENO SH.P.K
- (2) Themeluesi I shoqerise eshte:
-Nezaj, Denis

Neni 2

Objekti

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem

Ne fushen e tregtise,eksport-import,tregti me shumice e pakice.Ne fushen e ndertimit,transporteve,hotelerise.

Neni 3

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete nga 13.07.2017 deri ne nje afat te pa percaktuar.

Neni 4

Selia

- (1) Selia e shoqerise ndodhet ne Rrugen Frederik Shiroka,Njesia bashkiake nr.7,ish fusha e Zeze,pallati Gora,kati 1.
- (2) Adresa e shoqerise per qellime komunikimi elektronik eshte si vijon:
dnezaj1998@gmail.com

Kreu 2

Kapitali

Neni 5

Kapitali Themeltar

- (1) Kapitali Themeltar I Shoqerise eshte 100.000,00 leke.Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

1.Ortaku themelues Denis Nezaj: Zoterues I 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 100.000,00 leke qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Neni 6

Zvogelimi dhe zmadhimi I kapitalit

Kapitali I shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitali themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre,nepermjet emerimit nga gjykata kompenente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Kreu 3

Administrimi

Neni 7

Administrimi

- (1) Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise.Afati I emerimit eshte 5 vjet,me te drejte ripertesitjeje.Emerimi I administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.
- (2) Administratoret e nje shoqerije tregtare meme,sipas percaktimit te nenit 2007 te ketij ligji,nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerije te kontrolluar e anasjelltas.Cdo emerim I bere ne kundershtrim me keto dispozita eshte I pavlefshem.
- (3) Personi I meposhtem caktohet si Administrator I shoqerise

Te dhenat e identifikimit:

Specimenet e nenshkrimit:

Nezaj, Denis.

Adresa: Rruga Sabaudin Gabrani,
njesia nr.6,banese private,nr. 15/2.

Neni 8

Kompetencat e Administratorit:

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje te gjitha veprimtarite e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise,duke zbatuar politikat tregtare
- b)perfaqesoje shoqerine tregtare
- c)kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise
- d)pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor,bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise
- e)krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistences se shoqerise

f) kryeje regjistrimet dhe te dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit

g) te kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut

Neni 9

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statusit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administrator detyrohet:

1. a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne mjedis;

b) te ushtroje kompetencat qe I njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita

c) te vleresoj me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim;

d) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, present apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;

e) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.

2. Administratori gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. Nese administrator vepron ne kundersizim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte I detyruar ti demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standarteve te kerkuara.

4. Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administrator eshte I detyruar ti demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundersizim me dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

Kreu 4

Viti financiar -ekspertet

Neni 10

Viti Financiar

Viti financiar I shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti I pare financiar fillon nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 11

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel ekonomik tregtare te shoqerise,ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollët periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille I ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel I autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollët periodike te ushtruara,te cilat eshte I detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Kreu 5

Prishja-Organizimi I shoqerise

Neni 12

Prishja dhe Likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a)kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
- b)me vendim te asamblese se ortakeve
- c)me hapjen e procedurave te falimentimit
- d)nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723,date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".
- e) me vendim te gjykates

Prishja e shoqerise tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese,me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga ortaket.

Neni 13

Mosmarreshjet

Per mosmarreshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti,si dhe per cdo mosmarreshje qe mund te linde midis shoqerise dhe te treteve,do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Ortak I Vetem I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar

DENO SHPK

DENIS NEZAJ

